



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

Datë 20.04.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM (Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“BLERJE MATERIALE PASTRIMI”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Produkte pastrimi – 39830000-9;

Vlera e Fondit Limit: **4,160,320** (kater million e njëqind gjashtëdhjetë mijë e treqind e njezet) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: VKB-së nr. 100, datë 18.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **Shtojcës 9**;*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4**;*

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të

lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari percaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë

2.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertave, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), si dhe shtojcës 9 të DST-së.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të certifikuara të bilanceve të dy viteve të fundit, 2024 dhe 2025, të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e gërmës “c” të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

*Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

2.2.2 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet e fundit financiare, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, **duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit vlerës së përlogaritur të kontratës**, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.*

2.2.3 "Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (I ndryshuar); Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR".

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara dhënies së kontratës.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik"; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar), Neni 5, gërma "c" ku citohet se: "...përcakton numrin e kësteve të*

pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.2.4 Vërtetim i lëshuar nga shoqëria “Ujësjelles Kanalizime Tiranë” sha, i cili konfirmon pagesën e te gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit.)*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenin 39, pika 8 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Bashkia Tiranë nëpërmjet “Ujësjelles Kanalizime Tiranë” sha ka si objektiv kryesor garantimin e shërbimeve jetike të furnizimit me ujë në territorin e Bashkisë Tiranë ku dhe një nga prioritet bazë është mbledhja e të gjithë detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë. Qëllimi i vendosjes së këtij kriteri është për të siguruar Autoritetin Kontraktor që për dhënien e kontratës të kontraktohen operatorë ekonomik të cilët nuk kanë detyrime të pashlyera për furnizimit me ujë sipas objektin ku ushtrojnë aktivitetin, në Bashkinë e Tiranës. Vendsoja e këtij kriteri siguron institucionin e Bashkisë Tiranë edhe në rast detyrimesh të pashlyera, operatorët ekonomik kanë periudhën e nevojshme kohore për të shlyer këto detyrime përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Vendosja e këtij kriteri është propocion me objektin e kontratës, për sa kohë është detyrim i cdo shoqërie shlyerja e detyrimeve të shërbimeve të furnizimit me ujë në territorin ku ushtron aktivitetin, konkretisht Bashkia Tiranë.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një **vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës** që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë ne*

vlerën jo më pak se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi në përputhje me dispozitat ligjore.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë, për periudhën e garancisë së mallrave objekt prokurimit për 1 (një) vit, sipas kërkesës në specifikimet teknike.

Argumentimi: *Kriteri i kërkuar në lidhje me deklaratën, është vendosur në përputhje me pikën 8, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”*

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues për produktet objekt prokurimi me nr. 12, 13, 17, 18, 19, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar. Në rast paraqitje autorizim distributori, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një akt marreveshje/ dokument që verteton marrëdhënien midis prodhuesit dhe distributorit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit apo distributorit të autorizuar për qëllime verifikimi nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 dhe në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021. Kërkimi i autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar është i nevojshëm për të garantuar origjinën e mallrave, ligjshmërinë e tregtimit të tyre dhe aftësinë reale të operatorit ekonomik për t'i siguruar ato sipas kërkesave të procedurës. Përmes këtij dokumenti, autoriteti kontraktor krijon bindjen se operatori ekonomik nuk paraqet një ofertë thjesht formale për produkte të cilat në praktikë nuk i ka në dispozicion ose për të cilat nuk ka të drejtë furnizimi. Kjo merr rëndësi të veçantë në rastin e produkteve që lidhen me standarde të caktuara teknike, me përberje të veçante ose me kërkesa të posaçme sigurie dhe cilësie. Kërkesa është gjithashtu proporcionale, pasi zbatohet vetëm për produkte të caktuara të identifikuar nga autoriteti kontraktor si të tillë që kërkojnë një nivel më të lartë sigurie sa i takon origjinës dhe kanalit të furnizimit. Në rastet kur autorizimi lëshohet nga distributori, kërkesa për paraqitjen e dokumentit që vërteton marrëdhënien e tij me prodhuesin është e domosdoshme për të siguruar gjurmueshmërinë e plotë të zinxhirit të furnizimit.

2.3.4 Çertifikatë ISO 9001-2015 ose e përditësuar për sistemin e menaxhimit të cilësisë, të prodhuesit/ distributorit të autorizuar (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë), për prodhimin dhe tregtimin e produkteve të përcaktuara më sipër.

- Çertifikatë ISO 14001:2015, ose e përditësuar lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, të prodhuesit/ distributorit të autorizuar (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë), për prodhimin dhe tregtimin e produkteve të përcaktuara më sipër.

Argumentim: *Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.4 janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar,

... “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”, si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”.

2.3.5 Për produktet/ artikujt (detergjentë, solucione) me nr rendor 12, 17, 18 ,19 ,26, 27, 28, 29,30,31, 32, 33, 34, 35, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Skedat MSDS, SDS (skedat e sigurisë) apo ekuivalente të produkteve, ku ndër të tjera të dallohet qartë se produktet janë konform rregullave dhe direktivave përkatëse dhe deklaratat e konformitetit të lëshuara nga prodhuesi për përputhjen e standarteve të produkteve të ofruara me standartet CE.

Në skedat teknike të produktit, duhet të dallohet qartë përputhja e të gjitha karakteristikave të kërkuara me produktet e ofruara.

(Skedat teknike duhet të jenë në gjuhën shqipe, dhe nëse janë në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer e të noterizuara).

Argumentimi: *Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe të mbulohen dëmtimet e*

mundshme gjatë transportit. Kriteri i kërkuar në lidhje me deklaratën, është vendosur në përputhje me pikën 8, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues për produktet objekt prokurimi me nr. 26, 28, 29, 30, 33, duhet të paraqesë fletë analizat të lëshuara nga laboratorë të akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë për përqendrimin e lëndëve tensioaktive, me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike të kërkuara në zbatim të bazës ligjore në fuqi për detergjentët.

Argumentimi: *Kjo kërkesë mbështetet në nenin 79 të Ligjit nr. 162/2020, në nenin 40, pika 6, shkronja "c", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, si dhe në legjislacionin në fuqi për detergjentët, produktet jo-ushqimore dhe vlerësimin e konformitetit. Autoriteti kontraktor kërkon paraqitjen e fletë-analizave për përqendrimin e lëndëve tensioaktive për produktet e përcaktuara, pasi ky është një prej treguesve themelorë që lidhet drejtpërdrejt me perberjen, efikasitetin dhe perputhshmërinë e produktit me specifikimet teknike të kërkuara. Në rastin e detergjentëve dhe produkteve të pastrimit, perberja kimike nuk mund të vlerësohet vetëm nga përshkrimi tregtar, etiketa ose deklarimi i ofertuesit. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor ka çmuar të nevojshme që kjo perputhshmëri të provohet me dokumentacion laboratorik të lëshuar nga laboratorë të akredituar, të cilët ofrojnë garanci mbi saktësinë, objektivitetin dhe vlefshmërinë e rezultateve. Ky kriter lidhet jo vetëm me përmbushjen formale të specifikimeve teknike, por edhe me nevojën që produktet e furnizuara të jenë realisht të përshtatshme për përdorim në objekte publike, ku efektiviteti i higjienizimit, siguria e përdoruesve dhe respektimi i kërkesave ligjore kanë rëndësi të veçantë. Për rrjedhojë, kërkesa është e justifikuar, proporcionale dhe e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës.*

2.3.7 Operatori/ët Ekonomik duhet të paraqes/in deklaratë me shkrim që merr përsipër me mjetet e veta të realizojë shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi në kohë dhe në sasi sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: *Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe të mbulohen dëmtimet e mundshme gjatë transportit. Kriteri i kërkuar në lidhje me deklaratën, është vendosur në përputhje me pikën 8, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”*

Shënim: *1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje*

me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- *Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.*
- *Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike (termave të referencës):

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit, për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP (i ndryshuar), si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Argumentimi, sipas materialit të përgatitur nga struktura e posaçme:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “d”, dhe nenit 64, shkronja “a” të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar); Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar); nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar); nenit 76 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar); VKB-së nr. 100, datë 18.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026”; specialist e fushes kanë hartuar kërkesat për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, duke përcaktuar qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Specifikime teknike: për “Blerje materiale pastrimi”.

Specifikimet teknike hartohen si të tilla referuar nevojave të Autoritetit Kontraktor për mallrat objekt prokurimi. Specifikimet teknike për llojin e materialit i referohen standarteve në fuqi dhe janë si më poshtë vijon:

EMERTIMI ARTIKUJVE	SPECIFIKIMET TEKNIKE PER MATERIALE PASTRIMI
1.Fshesë merimangash me shkop	Fshesa për pastrimin e merimangave, të jetë e përbërë me fije të dendura e të buta plastike me gjatësi mbi 10 cm. Koka të jetë e montueshme dhe e çmontueshme. Bishti të jetë i gjatë jo më i shkurtër se 100 cm, i përbërë nga materiali metalik i veshur me një shtesë plastike. Fshesa dhe shkopi të kenë mekanizmin e rrotullimit nga e djathta në montim
2. Fshesë pastrimi pa bisht	Fshesa të jetë me fije të dendura, të buta plastike, me gjatësi mbi 10 cm. Të jetë për pastrim të ambienteve të brendshme. Të jenë rezistente gjatë forcës së fshirjes së sipërfaqes. Koka të jetë e montueshme dhe e çmontueshme me mekanizmin e rrotullimit nga e djathta në montim me shkopin. Vendi i vendosjes së shkopit të jetë standard. Pesha e saj të jetë jo më e vogël se 340 gr.
3. Fshesë me sfungjer dhe gome për pastrimin e xhamave	Sfungjeri të jetë i plotë dhe me material të butë për fërkimin e xhamit, pa e dëmtuar atë dhe goma të jetë elastike për pastrimin e shkumës apo solucionit në xham. Shkopi që përdoret për të mbajtur fshesën me sfungjer të jetë jo më i vogël se 25 cm dhe pesha e gjithë fshesës me sfungjer të jetë jo më e vogël se 216 gr
4. Kuti mbledhëse plehrash (kaci) me gominë dhe me bisht plastik	Kuti mbledhëse plehrash (kaci) me gominë dhe me bisht plastik: jo më pak se 70 cm të gjatë. Kacia të ketë gjerësi 21 cm, gjatësi 29 cm, thellësi 10 cm, +/- 2 cm marzh gabimi.
5 . Shkopa inoksi	Jo me të shkurtër se 120 cm. Materiali i shkopit të jetë alumini me veshje plastike. Të ketë mekanizëm montues (efekt vidhimi) dhe shumë rezistent
6. Shtupë për larje dyshemeje	E përbërë nga fibra tekstili me përbërje pambuku që thithin ujin shumë mirë. Dendësia e shtupës të jetë jo më e vogël se 250 gr. T'i bashkëngjitet shtupës, shkopi me veshje plastike me gjatësi normale, jo më të shkurtër se 100 cm, të jetë me efekt vidhimi. Materiali i shkopit të jetë alumini nga brenda dhe plastik nga jashtë.
7. Furça pastrimi lavamani	Furçë për pastrim efikas dhe higjienik. Bishti të jetë i përshtatshëm me pëllëmbën e dorës, fijet e furçës të jenë të forta për të pastruar sipërfaqet e vështira të lavamanit. Pesha jo më e vogël se 190 gr. Gjatësia e furçës jo më pak se 30 cm.

8. Furça për pastrimin e WC- së	Të jetë me fije të forta sintetike. Furçë për pastrim efikas dhe higjienik për pastrimin e sipërfaqeve të vështira. Furça të ketë mbajtësen e saj. Të jetë me peshë jo më shumë se 300 gr.
9. Furça për larje muri me pllaka	Furça për larje muri me pllaka: me bisht, të jetë e përberë me qime të gjata mbi 10 cm dhe me qime të buta. Koka të jetë e montueshme dhe e çmontueshme me mekanizmin e rrotullimit me shkopin. Shkopi me filetimit standard dhe me gjatësi jo më të vogël se 110 cm. Pesha e fshesës të jetë jo më e vogël se 340 gr dhe pesha e bishtit të jetë jo më e vogël se 140 gr
10. Lecka për larje xhamash (përmasa 38*38 cm)	Lecka të jetë me material mikrofibër, e përbërë me 80% poliester dhe 20% poliamid
11. Lecke pastrimi pllakash	Të jetë me formë drejtkëndore, e përbërë nga fibra tekstili të buta që thithin ujin shumë mirë, me material mikrofibër. Të ketë aftësi të heq nivelet më të larta të papastërtive. Dendësia e leckës të jetë jo më e vogël se 160 gr. Të ketë qëndrueshmëri, gjatësia e leckës të jetë jo më e vogël se 40 cm
12. Letër kasete banjo	Të jetë cilësore dhe e ambalazhuar në kuti kartoni në përshtatje me mbajtësen e letrës
13. Letra të lagura higjienike për të rritur (min100 fije /pako)	Me aromë natyrale, e përdorshme për higjienën min 100 fije/pako, për bebe dhe të rritur. Të jetë e testuar dermatologjikisht, ti përshtatet pH të lëkurës.
14 . Peceta pastrimi mikrofibër (3 fije/pako)	Të jenë cilësore, të përshtatshme për pastrimin e mobiljeve të ndryshme, me aftësi super thithëse të jenë me ambalazhim min 3 fije/pako
15. Kovë plastike me shtrydhje (10 liter)	të jetë plastike, e thellë dhe të kenë një dorezë mbajtëse nga sipër për transportimin e kovës, kova të jetë së bashku me kapakun e shtrydhjes së shtupës. Kapaciteti mbajtës të jetë me volum min 10 Litër
16. Kosh ambienti metalik me kapak (5 litër)	Kosh ambienti metalik me kapak, në forma të ndryshme, pjesa e sipërme e koshit të jetë me kapak që hapet me pedal ku të vihen qeset e koshit. Me volum min 5 Litër, material inox.

<p>17. Leter higjenike e paketuar (min 10 rulon /paketim)</p>	<p>Të jetë me paketim min 10 rulon/pako, fletëpalosje zig-zag në pako me fije dhe me shkëputje. Të jetë cilësore dhe e butë. Të jetë e tretshme në ujë.</p>
<p>18. Qese mbeturinash (35 litër)</p>	<p>Të jenë rezistente, të kenë kapacitet mbajtës min 35 litër dhe të përmbajë min 15 fije, të jenë të forta, materiali plastmasi. Të jenë të paketuara në formë ruloje. Gryka e qeses të jetë pa ose me lidhëse. Të jetë produkt i biodegradueshëm.</p>
<p>19. Qese mbeturinash (60 litër)</p>	<p>Të jenë të paketuara në formë ruloje me min 15 fije dhe vëllim min 60 litër. Pakoja e paketuar në formë ruloje. Të jetë produkt i biodegradueshëm</p>
<p>20. Doreza gome</p>	<p>të jenë rezistente ndaj kimikateve të detërgjentëve dhe kimikatëve të pastrimit. Të jenë për përdorim të larjes së murit e pllakave. Të jenë të qëndrueshme dhe të përshtatshme në përdorim dhe të padepërtueshme nga lëngjet.</p>
<p>21. Sfungjer enësh i thjeshtë</p>	<p>të jenë të përdorshëm për pastrim pjatash, tenxheresh dhe kazanësh. Të jenë me pore të vogla në përbërjen e sfungjerit dhe me rrjete teli të butë për pastrim sipërfaqesh të ashpra.</p>
<p>22. Sfungjer për pastrim hidrosanitaresh</p>	<p>Të jetë me pore të vogla në përbërjen e sfungjerit dhe me rrjetë teli të butë për pastrim sipërfaqesh të ashpra. Anësoret të jenë me kanal për mbrojtjen e duarve.</p>
<p>23 . Plastmas transparent</p>	<p>Të jetë cilësor me përmasa dhe përdorime të ndryshme</p>
<p>24. Allçi</p>	<p>Të jetë pluhur i bardhë prej gipsi të pjekur, që ngurtësohet pasi njomet në ujë. Paketim thasësh plastik</p>
<p>25. Gëlqere për lyerje</p>	<p>Të jetë llaç mbushës themelor me bazë gipsi, me përmbajtje polimerësh dhe aditivësh special për mure tulle ose blloku për ambiente të brendshme. Material në formë pluhuri me bazë gipsi, gëlqere e hidratuar, granulometri të seleksionuar rezina sintetike dhe aditive special për aplikime në ambiente të brendshme. Të jetë pa rrëshkitshmëri vertikale, me punueshmëri shumë të mirë, ngjitje shumë e mirë nëpër mure dhe tavane dhe me rezistencë të lartë mekanike. Të jetë cilësore. I ambalazhuar në paketim 1 ose >1 Kg sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor</p>

<p>26. Solucion larës xhamash 750 ml</p>	<p>me efekt pastrimi dhe shkëlqim të xhamave. Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm sprucimi. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 11. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Solucioni të jetë homogjen dhe të ketë densitet 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³ . Lënda tensioaktive të variojë nga 1.0% deri në 4.0%</p>
<p>27. Solucion larës enësh lëng 1 litër</p>	<p>Solucioni të jete me efekt pastrimi të thellë. Ambalazhimi në shishe plastike dhe të ketë analizën spektrale në etiketë. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion homogjen dhe viskoze, të ketë aromë parfumi. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Vlera e PH 6 deri në 10. Faqe 13 nga 27 Densiteti të variojë nga 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³ . Lënda tensioaktive të jetë nga 15% deri në 20%</p>
<p>28. Sapun i lëngshëm 1 litër</p>	<p>Ambalazhimi nga fabrika në shishe plastike me mekanizëm në pjesën e trupit të shishes për manovrim të produktit gjatë përdorimit. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion viskoz dhe homogjen. Të mos jetë irritues me lëkurën e duarve. Vlera e PH jo më vogël se 5.5 dhe jo më e madhe se 8. Densiteti i lëngut të jetë 0.9 deri në 1.1 Faqe 14 nga 27 gr/cm³ . Aromë parfumi. Tretshmëria në ujë 100%. Lëndët tensioaktive të jenë nga 5.0 deri në 11%. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës</p>
<p>29. Solucion larës dyshemeje (pllakash)</p>	<p>Solucioni të jetë me veti të mira pastruese dhe aromatizuese. Ambalazhimi në shishe plastike. Gjendja fizike: të jetë solucion lëng, me aromë parfumi. Vlera e PH të jetë 5 deri në 10. Paraqitja fizike e solucionit të jetë homogjene. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ -1.1 gr/cm³ . Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 10%. I përshtatshëm për vende higjienike, dhoma zhveshje, palestra dhe kudo ku ka probleme arome të pakëndshme. Ambalazhimi në bidon plastik me konfeksione sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.</p>
<p>30. Detergjent kundër njollave (sgrasatore) 750 ml</p>	<p>Largon pluhurin, vajin dhe ndotësit e tjerë. Me veti zbutëse të papastërtive</p>
<p>31. Sapun rrobash 100 gr</p>	<p>Të jetë cilësor, me aftësi shkumuese të lartë. Ambalazhimi nga fabrika. Paraqitja fizike të jetë i ngurtë, paketimi të ketë të evidentuar markën dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë 7 deri në 10. Densiteti të jetë 0.9 deri në 1.2 gr/cm³ . Tretshmëria në ujë të jetë jo më e vogël se 95%. Lartësia e shkumës të jetë jo më e madhe se 5 cm.</p>
<p>32. Acid për pastrim</p>	<p>Acidi të jetë solucion efikas në heqjen e kripërave të depozituara si dhe papastërtive. Zbardhës alkaline me aftësi vepruese dezinfektante. Ambalazhimi në shishe plastike. Të përmbaje në masën 12% deri në 30% acid klorhidrik. Vlera e pH 0-3. Densiteti i acidit të jetë 1.0 deri 1.5 gr/cm³ . Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës</p>

<p>33. Solucion larës WC disinfectues 1 Litër</p>	<p>Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm për pastrim më të thellë të anëve të WC. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë jo më e madhe se 13 dhe tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.1 gr/cm³. Përmbajtja e klorit të jetë jo më e madhe se 3.5%.</p>
<p>34. Solucion për pastrimin e smërcit /kriprave nga hidrosanitaret me mekanizëm sprucimi</p>	<p>Ambalazhimi në shishe plastike për larje të lavamanit, sanitaret e tualetit, të pastrojë në thellësi kriperat e ujit nga hidrosanitaret. Të parandalojë krijimin e kriperave. Të ketë aromë parfumi dhe substanca mbrojtëse për lëkurën e duarve. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjene. Vlera e PH jo më e madhe se 2.5 dhe jo më e vogël se 1.5. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.</p>
<p>35. Solucion për zhbllokim lavamani 1 Litër</p>	<p>Me efekt zhbllokimi të shpejtë, të mos krijojë shkumë dhe të mos dëmtojë tubat plastike. Ambalazhimi në qese plastike ose kuti kartoni trajtë pluhuri sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.</p>
<p>36. Aromatizues zyre 300 ml</p>	<p>Të jetë me sprucim, i përshtatshëm për ambiente zyre. Neutralizon aromat e ambientit, shpërndan aromë të freskët.</p>
<p>37. Çizme gome të shkurtra</p>	<p>Me material gome cilësor, të ofrojnë mbrojtje ndaj ujit. Numrat çizmeve dhe ngjyra sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor</p>
<p>38. Shtupë profesionale tharëse për dysheme</p>	<p>Shtupa të jetë me fije akrilike me mikrofibër, jo më të vogël se 60 cm. Përdoret për të tharë dyshemenë pas larjes ose për të fshirë në dyshemenë të thatë pa ngritur pluhur.</p>
<p>39. Gota plastike (50 copë / pako)</p>	<p>Të jenë cilësore. Paketimi në qese plastike jo më pak se 50 copë/ pako, jo më shumë se 200 ml madhësia e nxënies së gotës. Të jenë të biodegradueshme dhe një përdorimëshe.</p>
<p>40. Mbulesë tavoline tekstil (përmasa 140*180)</p>	<p>Të ketë përbërje pambuku dhe poliestër. Ngjyra sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.</p>

